



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA MBLEDHJA E VEÇANTË E KUVENDIT TË KOSOVËS ME RASTIN E
MIRATIMIT TË DEKLARATËS PËR MBËSHTETJE TË MENDIMIT TË GJND-së
NË HAGË, MBAJTUR MË 23 KORRIK 2010

SA POSEBNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA POVODOM USVAJANJA
DEKLARACIJE O PODRŠCI MIŠLJENJA MSP U HAGU, ODRŽANE 23 JULA 2010.
GODINE

KORRIK – JULI
2010

E hënë, 23 korrik 2010

Seancën drejton: kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra prezentë,
Mirë se keni ardhur në mbledhjen e veçantë të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 15, paragrafi 3 dhe nenin 42 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme, me të vetmen pikë të rendit të ditës:

**- Miratimi i Deklaratës për mbështetje të mendimit të Gjykatës
Ndërkombëtare të Drejtësisë**

Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë,

Duke çmuar lart opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, të shpallur më 22 korrik 2010, për ligjshmërinë e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, në mbështetje të nenit 65.1 të Kushtetutës dhe të nenit 6.1 të Rregullores së vet të Punës,

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën e veçantë të datës 23 korrik 2010, miratoi solemnisht këtë:

DEKLARATË

Kuvendi i Republikës së Kosovës shpreh kënaqësinë dhe aprovimin për opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për legalitetin ndërkombëtar të shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe zotohet për respektimin e tij.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, me profesionalizëm të lartë dhe me paanshmëri ka rikonfirmuar respektimin e të drejtës ndërkombëtare me rastin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, duke i dhënë vulën e ligjshmërisë vullnetit të shprehur të qytetarëve të Kosovës dhe të drejtës së tyre për vetëvendosje.

Duke i dhënë legalitetin ndërkombëtar Deklaratës së Pavarësisë, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë i ka hapur rrugë të reja Republikës së Kosovës drejt njohjes së gjerë ndërkombëtare, drejt marrëdhënieve me vende dhe popuj anekënd botës, drejt bashkëpunimit rajonal dhe drejt zhvillimit e integriteteve euroatlantike.

Kuvendi i Republikës së Kosovës shpreh bindjen se vendimi historik i Gjykatës

Ndërkombëtare të Drejtësisë do t'i kontribuojë paqes dhe stabilitetit, jo vetëm në Republikën e re të Kosovës, por në gjithë rajonin tonë, sepse Kosova do të jetë e përkushtuar fuqishëm të respektojë të drejtën ndërkombëtare, të ndjekë besnikërisht politikën e bashkëpunimit, të fqinjësisë së mirë dhe të mirëkuptimit e të dialogut.

Shprehim gatishmërinë tonë të sinqertë për të vendosur marrëdhënie të mira me Republikën e Serbisë, në të mirë të të dy popujve tanë dhe të stabilitetit e të prosperitetit politik, social dhe ekonomik të rajonit tonë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës përshëndet ftesën e djeshme të Bashkimit Evropian për fillimin e dialogut midis Kosovës dhe Serbisë, në dobi të zgjidhjes së çështjeve teknike dhe të interesit të përbashkët të qytetarëve të të dyja vendeve, duke përjashtuar njëkohësisht çfarëdo mundësie të negociimit të statusit politik të Kosovës, të integritetit territorial dhe të kushtetutshmërisë së saj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës falënderon të gjitha shtetet që e kanë përkrahur Kosovën në të gjitha proceset politike dhe sidomos për kontributin e tyre në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, duke u zotuar se Kosova do ta arsyetojë plotësisht besimin ndërkombëtar.

Shprehim mirënjohjen tonë dhe të të gjithë popullit të Republikës së Kosovës për institucionet ndërkombëtare, komunitetin ndërkombëtar në përgjithësi dhe sidomos për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian dhe të gjitha vendet veç e veç që e kanë njohur shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës, me bindje se edhe shtete të tjera do ta njohin Republikën e Kosovës si anëtare të ardhshme të bashkësisë së kombeve të lira dhe demokratike.

Kuvendi i Republikës së Kosovës me këtë rast solemn i shpreh edhe njëherë mirënjohje të thellë gjithë prezencës ndërkombëtare në Kosovë, civile dhe asaj të sigurisë, duke vlerësuar lart kontributin e saj.

Duke pasur parasysh konfirmimin ligjor ndërkombëtar të pavarësisë dhe të sovranitetit të Republikës së Kosovës, i bëjmë thirrje Bashkimit Evropian për unifikim të plotë për Kosovën, por edhe shteteve që kanë hezituuar ta njohin shtetin tonë, ta bëjnë këtë në emër të paqes dhe të zhvillimit, në emër të marrëdhënieve të mira e miqësore midis Kosovës dhe popullit të saj me vendet dhe popujt e botës, në emër të së drejtës legjitime të Kosovës për të qenë anëtare e denj e familjes së madhe të Kombeve të Bashkuara.

Kuvendi i Republikës së Kosovës i kërkon Qeverisë që të angazhohet intensivisht në aktivitetin politik e diplomatik të njohjes së gjerë ndërkombëtare të Republikës së Kosovës.

Republika e Kosovës edhe njëherë konfirmon zotimin e saj të shprehur në Deklaratën e Pavarësisë për të qenë një shtet demokratik, laik dhe multietnik, i udhëhequr nga parimet e mosdiskriminimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të të gjitha komuniteteve në Kosovë

dhe të krijojë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen e tyre efektive në proceset politike dhe vendimmarrëse.

Institucionet e Republikës së Kosovës do të jenë të përkushtuara për përgatitjen e shtetit tonë për integrimet euroatlantike dhe për t'i respektuar e përvetësuar të gjitha vlerat evropiane dhe euroatlantike.

(Duartrokitje)

Të nderuar deputetë, me një duartrokitje përshëndesim këtë Deklaratë dhe mbështetjen e Kosovës nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.

(Duartrokitje)

Pas kësaj mbështetjeje që Kuvendi i Republikës së Kosovës i dha opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, e mbyll këtë seancë, duke ju ftuar në një koktej rasti. Vazhdimin e seancës së djeshme do ta kemi të hënë, kurse seancën e të hënës e vazhdojmë të martën. Mirupafshim!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës